

Data 25/07/2023

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbim

### PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** "Mirëmbajtje impjantesh elektrike për Qëndren Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për mbulimin e nevojave 24 mujore., si më poshtë:

#### KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

*Riparime dhe mirëmbajtje impiantesh- 45259000-7*

*Pajisje elektrike- 31681000-3*

#### VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **5,278,157** (pesë milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ***Qendra Spitalore Universitare “ Nene Tereza” Tirane*** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

##### *a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, në të cilën është e parashikuar se:

- 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
- 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

##### *b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;*

**Argumentimi:** Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

##### *c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”.

#### d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001:2015 (Certifikate per sistemimin e menaxhimit te Cilesise)**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Këto kriterë të percaktuar ne piken a) dhe b) janë vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. *Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.** Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e*

Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2020, 2021dhe 2022) ku vlera mesatare e tyre te jete **jo me e vogel se 40 % e vlerës së fondit limit\* për të cilat konkurron operatori.**

***Shënim\*:** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40 % do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në Seksionin: 2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës/Marrëveshjes Kuadër, pika 1.*

**Argumentimi:** Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar në kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.*

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund

të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika2/a: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;* Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **40 % e vlerës së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori, eshte nje deshmi e mjaftueshme per te krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 20% e vlerës së fondit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata/kontratat perkatese te shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses te saj/te tyre, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Shënim\*:* Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në Seksionin: 2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës/Marrëveshjes Kuadër, pika 1.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" , ne te cilin gjejme te përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe

profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.2.** Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 20 (njëzet) persona të punësuar, të siguruar për periudhën minimalisht muajin e fundit. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, minimalisht muajin e fundit.
- Listë pagesat e punonjësve për periudhën perkatëse të konfirmuar nga Administrata Tatimore (në formë elektronike);

*(Kjo kerkese do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në mbështetje të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, neni 41, pika 4, gërma ‘b’ si dhe referuar Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike nr 254/6 prot., datë 10.02.2023, në “Kërkesën për rihapje procedure“ të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Sektori Teknik, me nr.254/22 prot., datë 20.07.2023.

**2.3.5.** Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

- **1 (një) punonjës të kualifikuar si specialist/ ekspert zjarrfikës**, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të pajisur me certifikatën përkatëse të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

- **1 (një) punonjës të trajnuar si specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë**, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.10327, date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM-së nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier".

- **1 (një) punonjës të kualifikuar si auditues energjitik në ndërtesa**, në përputhje me Ligjin nr.124/2015 “Për eficientësin e energjisë”, të pajisur me certifikatën përkatëse si auditues energjitik në ndërtesa;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr. 9. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë: *Kontrate pune / Certifikatat e cituara më sipër.*

**2.3.3** Operatorët ekonomike duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi"*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- NS 14-A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.

**Shenim:** *Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM-ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një*

*kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

#### **4 (katër) punonjës elektrikist**

Per punonjesin elektrikist duhet te paraqitet kontratat e punes , dokumenti certifikues (deftese dhe/ose diplome dhe/ose Dëshmi kualifikimi të sigurimit).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës nr. 9. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë: *Kontrate pune / Certifikatat e cituara më sipër.*

*Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë sesa një kualifikim/ trajnim nga ato të kërkuara më sipër.*

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të deklaroj se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos ne mbështetje te ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, neni 41, pika 4, gërma ‘b’ si dhe referuar Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike nr254/6 prot.,datë 10.02.2023, në “Rikërkesën për hapje procedure“ të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Sektori Teknik, nr.254/22 prot., datë 20.07.2023.. Kriteret e vendosura 5) dhe 6) është vendosur nga anetari i NjP qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe është ne perputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik

#### **Shënim për operatorët ekonomik:**

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së

*afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II.Argumentimi i specifikimeve teknike**

Shtojca 5.

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

#### **Të sistemit të furnizimit me energji elektrike, sistemit të orëve dhe diktim-sinjalizimit të zjarrit në SPITALIN E RI**

Sipërmarrësi do të kryejë riparim-mirëmbajtjen e këtyre sistemeve duke zbatuar të gjitha procedurat e duhura teknike dhe ligjore.

Sipërmarrësi do të realizojë shërbimet periodike të mirëmbajtjes, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit sipas me “Urdhërave të Punës” të lëshuar nga përfaqësuesi i QSUT.

---

Sipërmarrësi do të kryejë shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes javore e mujore.

Qëllimi i kryerjes së shërbimit të riparim-mirëmbajtjes së kabinës elektrike të Spitalit të Ri është që të sigurohet gadishmëria, vazhdimësia në punë në kushte optimale dhe brënda normave të sigurimit teknik.

Shërbimi i mirëmbajtjes duhet të përqëndrohet në:

Shërbime javore (A1-A11), shërbimet 3-mujore B1-B2, shërbimet 6-mujore C1-C2.

#### **A/1) Verifikimi i kabinës së transformimit:**

Verifikimi i temperaturës së funksionimit të transformatorit dhe kontrole të tjera të lidhjes "A".

Verifikimi i funksionimit të grupit të ndërhyrjes në qarqet ndihmës.

Verifikimi i qarqeve ndihmës.

Verifikimi i funksionimit të nxjerrjes së ajrit dhe termostatit përkatës në ambientin e komandimit.

Verifikimi i gjëndjes të dorezave izoluese dhe tapeteve.

Pastrimi i përgjithshëm e ambientit dhe e grilave të shkëmbimit të ajrit.

#### **A/2) Verifikimi i grupit të gjeneratorit si edhe shërbimi periodik i tij:**

Prova e ndërhyrjes në automatikë me anë të simulimit të mungesës të rrjetit OSHEE.

Vënia në punë në mënyre periodike për një kohëzgjatje prej 1 ore për të kontrolluar te gjithë parametrat e nevojshëm të gjeneratorit. Ky veprim do të bëhet me radhë për secilin gjenerator dhe realizohet me "Urdhër Pune" të veçantë.

Stimulimi i lidhjes së 2 gjeneratorëve në paralel, për të rritur shkallën e sigurisë së impiantit.

#### **A/2-2) Shërbimi periodik i grupit të gjeneratorëve:**

Ndërrimi i filtrave të vajit, ajrit, naftës dhe të ujit.

Ndërrimi i vajit

Kontroll vizual i gjëndjes së përgjithshme të gjeneratorit,

Kontroll i jashtëm i gjëndjes së motorrit,

Kontroll i jashtëm i gjëndjes së gjeneratorit,

Kontroll i tubacioneve të sistemit të furnizimit me karburant,

Kontroll i gjëndjes fizike dhe regjistrimi i rripave të transmetimit të lëvizjes,

Kontroll i kuadrit të automatikës që përmbledh kontrollin e sistemit të kontrollit të parametrave dhe atij të komandimit automatik,

Kontroll vizual i serbatorit për rrjedhje,

Kontroll i gjeneratorit për shpërndarje ngarkese nëpër fazë,

Kontroll i lëngut ftohës në radiator,

Kontroll i baterisë terminaleve, elektrolitit dhe niveli të tensionit të saj,

Testim i gjeneratorit në ngarkesë maksimale.

### **A/3 Verifikimi i POËER CENTER në Godinën Teknike B**

Prova kampion i automatëve diferencial nëpërmjet pulsantit TEST,

Prova kampion e automatëve magneto-termik nëpërmjet instrumentit përkatës për rrymat termike edhe të lidhjes së shkurtër,

Kontrolli termik i automatëve nëpërmjet instrumentit me INFRARED, i cili mundëson kontrollin në distançe të tyre,

Prova me instrumentat elektronik për verifikimin e kohës sëndërhyrjes dhe parametrave përkatës,

Prova e logjikës së funksionimit të POWER CENTER, duke provokuar ndërhyrje të ndryshme në llogjikën e funksionimit,

Verifikimi i funksionimit të llampave të sinjalizimit të POWER CENTER-it,

Kontrolli i gjëndjes të shkarkuesve të mbitensionit,

Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës,

Verifikimi i tokëzimit etj.

### **A/4 Verifikimi i blindosbarrës kryesore të furnizimit të objektit**

Verifikimi vizual i gjithë linjës së blindosbarrës kryesore të furnizimit (3200A) për dëmtime mekanike apo korruzive.

Matja në mënyrë periodike e izolacionit nëpërmjet instrumentit përkatës me tension jo më shumë se 2000Volt,

Verifikimi i të gjitha parametrave teknik të blindosbarrës nën tension pa ngarkesë,

Verifikimi i të gjitha parametrave teknik të blindosbarrës nën tension me ngarkese të plotë.

### **A/5 Verifikimi i POWER CENTER në godinën teknike A.**

Prova kampion i automateve diferencial nëpërmjet pulsantit TEST,

Prova kampion e automatëve magneto-termik, nëpërmjet instrumentit përkatës për rrymat termike dhe të lidhjes së shkurtër.

Prova me instrumentat elektronik për verifikimin e kohës së ndërhyrjes dhe parametrave përkatës,

Prova e llogjikës së funksionimit të POWER CENTER, duke provokuar ndërhyrje të ndryshme në llogjikën e funksionimit,

Verifikimi i funksionimit të llampave të sinjalizimit të POWER CENTER-it,

Kontrolli i gjendjes të shkarkuesve të mbitensionit,

Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës,

Verifikimi i tokëzimit etj.

#### **A/6 Verifikimi i paisjeve të UPS1, 2, 3**

Pastrimi i gjithë pjesëve të brëndshme të pajisjes,

Kontrollin funksional të parametrave të pajisjes së bashku me matjet përkatëse,

Kontroll dhe verifikim i anës cilësore të baterive që garanton kohëmbajtjen e pavarur të ngarkesës së punës nga burimet e tjera të rrymës alternative, që janë linja nga OSHEE dhe gjeneratori.

Kontrolli i funksionimit të linjës BY- PASS,

Shtrengimi i morseterisë,

Kontrolli i cilësisë të mbrojtjes të furnizimit me energji të pajisjes, si dhe asaj të transmetuar, Verifikimi i gjendjes të sistemit të tokëzimit duke iu referuar tokëzimit kryesor të objektit në të cilën është e instaluar UPS.

Në të gjitha rastet si me bateri të inkluduara në UPS ashtu edhe me bateri të jashtme kryhet ndarja e linjës pozitive nga ajo negative dhe bëhet matja e kapacitetit të dy linjave.

Shtrengimi i të gjithë urave të lidhjes së baterive në seri,

Kontrolli dhe pastrimi i poleve të baterive.

#### **A/7) Verifikimi i impiantit të ndricimit të sigurisë së emergjencës:**

Prova e ndërhyrjes automatike në mungesë të rrymës OSHEE,

Testimi i kohëzgjatjes së ndricuesave të emergjencës,

Zëvendësimi i llampave të emergjencës në rast të dëmtimit të tyre,

Zëvendësimi i paketës së baterisë së emergjencës në rast dëmtimi,

#### **A/8 Kontrolli i kuadrove elektrik në nivel kati si dhe kuadrot kryesore të shpërndarjes.**

Prova kampion i automatëve diferencial nëpërmjet pulsantit TEST,

Prova kampion e automatëve magnetotermik nëpërmjet instrumentit përkatës për rrymat termike dhe të lidhjes së shkurtër,

Kontrolli termik i automateve nëpërmjet instrumentit me INFRARED, i cili mundëson kontrollin në distancë të tyre,

Prova me instrumentat elektronik të matjes, për verifikimin e kohës së ndërhyrjes dhe parametravepërkatës,

Kontrolli i gjëndjes të shkarkuesve të mbitesionit,

Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës,

Verifikimi i tokëzimit etj.

#### **A/9 Verifikimi i impiantit të ndricimit godinës A dhe B**

Kontrolli vizual i impiantit të ndricimit,

Testimi i qarqeve të komandimit të ndricimit,

#### **A/10) Verifikimi sistemit të sinjalizimit të zjarrit.**

Prova në kampion e sensorëve të tymit me anë të bombulës së testimit,

Pastrimi i sensorëve me anë të mjeteve të nevojshëm për këtë qëllim,

Zëvendësimi i sensorëve në rast të dëmtimit të tyre,

Verifikimi i paneleve lokal të sinjalizimit të zjarrit të ndarë në nivel kati,

Verifikimi i magnetëve të dyerve duke bërë edhe mirëmbajtjen e rastit,

Testimi i sistemit të sinjalizimit të zjarrit me sektorë lokal, për të parë gjithë veprimet automatike që sistemi i zjarrit duhet të kryejë,

Verifikimi i ushqyesave lokal që furnizojnë me energji magnetët e dyerve,

Verifikimi i sistemit audio të EVAKUIMIT në rast zjarri.

#### **A/11 Verifikimi i sistemit të thirjes së infermierisë.**

Kontrolli vizual i paisjeve të sinjalizimit të infermieres,

Testimi i paisjeve dhe verifikimi i thirjes nga dhoma deri në sallën e infermieres.

## **VEPRIME MUJORE.**

Përsëritja e veprimeve (javore) dhe gjithashtu:

B/1 Verifikimi i shtrënguar i morsetave dhe të pikave të paisjeve të instaluar në borde, në kuadrin kryesor dhe kuadrot e tjerë elektrik të shpërndarjes.

B/2) Pastrimi komplet i lokalit teknik, kabinës, paisjeve të kuadrit, kuadrot kryesore , kuadrove dytësore, për të eliminuar grumbullimet e pluhrave në të gjitha paisjet e instaluara në to, duke përdorur fshesën me korent, një kujdes i veçantë duhet të ushtrohet në pastrimin e grilave të ventilimit, të instaluara si në makineri dhe në faqet e saj.

## **VEPRIMET TRE-MUJORE**

Përsëritja e veprimeve, javore dhe mujore, si dhe:

C/1) Kabina e transformimit me trasformator të thatë:

·Kontrolli si në lidhjen "A"

C/2) Prova e ndërhyrjes së paisjeve ckycese të

·Panelit të TU.

·Çkycja e kabinës së trasformatorit

Ngarkesat e lidhura nga gjeneratori me funksionim të njëkohshëm (prova e C'kycjes automatike edhe manuale)

Verifikimi i funksionimit të llampës së sinjalizimit të qarqeve c'kycese.

Janë parashikuar zërat të furnizim vendosje, pjesë material për sistemin e sinjalizimit të zjarrit, sistemit të evakuimit, kuadrove elektrike, si në Qëndrën teknik B, ashtu dhe A, dhe A1 e A2.

Nga niveli -1 deri në nivelin +2, janë 8 dhoma teknike në nivel kati në 2 godinat: A1 dhe A2 janë panele 0.4kv, ku magjistralet kryesore dalin nga qendra teknike B, në nivelin bodrum dhe drejtohen në 2 drejtime godinash A1 dhe A2, për 4 nivele kate. Panelet janë me automatë 3 fazore 4 polar fuqie, të cilat shpërndajnë po në nivel kati.

Për këto panele janë parshikuar, Furnizim-Vendosje automat, si më poshtë:

Furnizim vendosje automat 1P+N, TIP C6KA DPN 6A,10,16A, 20A, 32A, 40A.

Furnizim vendosje automat 3P+N, TIP C6KA DPN 10A,16A, 40A, 32A.

Furnizim vendosje automat DC 2P C10KA C60H, 16A, 20A, 40A 63A

Furnizimi vendosje automat 4P D10KA C60H 10A, 20A, 32A, 40A, 80A, 100A, 125A.

Furnizim vendosje llamba neoni 18w, 36, 58w, drozela e startëra, për ambientet në qendrat teknike transformimit B.A, A1 A2 dhe në nivele kate .

Në sistemin e sinjalizimit të zjarrit është parashikuar :

Furnizim vendosje sensore tymi, sirenë temperaturë të adresueshme.

Furnizim vendosje ushqyes për magnetet e dymve 24v 2,5A.

Furnizim vendosje magnet dymsh,

Furnizim vendosje pulsant sinjalizimi ndaj zjarrit.

Për moto-gjeneratorët automatik të tipit C.T.M job 6830, me panel automatike, Marka GARIBOLDI janë parashikuar jo vetëm shërbimet periodike javore, mujore , 3 mujore dhe 6 mujore, sipas specifikimeve teknike por dhe zëra të karakterit furnizim vendosje si:

Furnizim vendosje filtra naftë, ajri, bateri 250A, 24V dhe vaj, sipas karakteristikave në vend.

Kontrolli i kuadrit të automatikës që përmbledh kontrollin e sistemit të kontrollit të parametrave dhe atij të komandimit automatik të 2 gjeneratorëve. Është shumë e rëndësishme programimi i saj.

Shërbimet dhe riparimet, që do të kryhen janë të përshkruara në preventivat bashkëngjitur,

Riparimet e castit duhet të kryhen me marrjen e njoftimit.

Për çdo shërbim e riparim, që do të kryhet hapet urdhër pune me preventiv bashkëngjitur, i cili merret nga preventivi fitues.

### **Kërkesat teknike për sistemin e furnizimit me energji elektrike nga rrjeti dhe motogjeneratorët janë:**

- 1- Operatorët ekonomik duhet të njihen me preventivin e punimeve, gjendjen faktike të kabinave, moto-gjenerator dhe të deklarojnë që marrin përsipër mirëmbajtjen e tyre.
- 2- Operatori ekonomik të kenë persona përgjegjës inxhinier elektrik, që të përgjigjen për riparim defekteve në cdo kohë dhe të kenë shërbim 24 orë, ditë të shtuna, diela e festa zyrtare , për riparimet e castit duhet të kryhen me marrjen e njoftimit ndërsa për shërbimet periodike kryhen periodikisht cdo muaj sipas urdhërit të punës.
- 3- Operatori ekonomik, duhet të kontaktoj cdo ditë me personat përgjegjës të Sektorit Teknik dhe duhet të raportojnë për anomali apo defekte gjatë natës.
- 4- Operatori ekonomik do të emërojë një person përgjegjës të sigurisë në punë, një përgjegjës për të vëzhguar, sic është përshkruar më sipër për punimet për ti komunikuar normat e parashikura nga QSUT-ja .

- 5- Operatori ekonomik do të angazhojë për shërbimet e mirëmbajtjes të Impiantit- elektrik të QSUT-së, një staf të specializuar, të punësuar pranë firmës konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.
- 6- QSUT-ja jep ndihmën teknike Operatorit ekonomik, në rast të difekteve me azhornime dhe Operatori ekonomik duhet që në çdo rast të paraqes ndryshimet në këto azhornime.
- 7- Operatoriekonomik,angazhohet të kryejë shërbimet për mirëmbajtjen e impiantit elektri të QSUT në një kohë sa më të shkurtër, për të bërë të mundur njëkohë sa me minimale të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike kur kjo të jetë e domosdoshme.
- 8- Operatori ekonomik do marrë përsipër që, në rast madhor të një defekti të rëndë të djegjes së një transformatori, të japë furnizim me energji duke montuar transformatorin rezervë që disponon QSUT në bashkëpunim me specialistë të energjitikës.

## **Kërkesat teknike mbi sistemin e furnizimit me energji elektrike të sistemit të orëve**

### **diktim-sinjalizimi i zjarrit në Spitalin e Ri**

#### **Ofertuesi**

Të kryejë të gjitha shërbimet e nevojshme të verifikimit dhe kontrollit, nga personeli i saj i specializuar dhe i kualifikuar sipas normave të mirëmbajtjes.

Të përgatisë dhe të japë QSUT-së, një informacion të detajuar të impiantit elektrik, në të cilin do të evidentojë:

- a. Përshkrime tregtare dhe karakteristikat e veçanta të gjithë produkteve,
- b. Ndërhyrjet jo të parashikuara nga plani i mirëmbajtjes,
- c. Numrine saktë të të gjitha shërbimeve të realizuara, dhe atyre të kërkuara dhe të parashikuara nga plani mirëmbajtjes.

